



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2018, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”” (*Komision përgjegjës*)
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar””, nismë e Këshillit të Ministrave (*Komision përgjegjës*)
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar””, nismë e deputetëve.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço.

#### **Marrin pjesë:**

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Illir Bejko –Drejtor i Oponencës Ligjore ne Drejtorinë e Përgjithshme te Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Selmani – Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Gian Luigi Pratola – ekspert ndërkombëtar në Misionin Ndërkombëtar “EURALIUS”

Tedi Dobi – Ekspert në Misionin Ndërkombëtar “EURALIUS”

Bledar Doracaj – Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Viktor Gumi – ekspert

Vangjel Kosta – ekspert

Raimonda Bozo – eksperte

Rudina Brari – eksperte

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me pikat që kemi në rendin e ditës. Sot do të shqyrtojmë 3 çështje, projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar””. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision përgjegjës.

Pika e dytë është projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar””, nismë e Këshillit të Ministrave. Edhe për këtë projektligj jemi komision përgjegjës.

Çështja e fundit është projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar””, nismë e deputetëve, ku edhe për nismë Komisioni i Ligjeve është komision përgjegjës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar””. Relator i këtij projektligji është zoti Adnor Shameti. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zonja Teuta Vodo, zëvendësministre, zoti Ilir Bejko, drejtor i Oponencës Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit. Nga Prokuroria e Përgjithshme, zoti Artur Selmani, prokuror dhe nga Misioni Ndërkombëtar EURALIUS, zoti Gian Luigi Pratola, ekspert ndërkombëtar dhe zoti Tedi Tobi, ekspert.

Ju lutem, zoti Pratola, zini vend!

Ky projektligj është një nga projektligjet e paketës së dytë të reformës në drejtësi. Është depozituar si nismë deputeti, konkretisht këtë nismë e ka depozituar kolegja Vasilika Hysi, ndaj pa humbur kohë po ia kaloj fjalën koleges Hysi për të na bërë prezantimin e ndryshimeve që propozohen në projektligjin për ekzekutimin e vendimeve penale.

Fjala për zonjën Hysi.

**Xhemal Qefalia** – Për procedurë, ju lutem!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Ky projektligj ka kaluar edhe në Komisionin e Sigurisë dhe nuk e di nëse kanë ardhur në sekretarinë e Komisionit të Ligjeve vërejtjet dhe sugjerimet nga Komisioni i Sigurisë.

**Ulsi Manja** – Me aq sa unë kam konfirmim nuk ka ardhur ende raporti i Komisionit të Sigurisë lidhur me projektligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, por nëse është trajtuar në Komisionin e Sigurisë, ta prezantojmë nismën, të dëgjojmë edhe relatorin Shameti dhe sot mund ta miratojmë në parim, ndërsa shqyrtimin nen për nen mund ta shtyjme miratimin derisa të vijë edhe raporti i Komisionit të Sigurisë.

**Vasilika Hysi** – Përshëndetje!

Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë,

Nisma që keni përpara ka si qëllim të bëjë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”. Që në fillim do të doja t’ju bëja me dije se ky ligj është ligj i miratuar në prill të vitit 1998, pra para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka pësuar shtesa dhe ndryshime në vitet në vazhdim dhe në kuadrin e reformës në drejtësi grupi i ekspertëve të nivelit të lartë bëri një analizë të shtyllës së tretë të drejtësisë penale, pjesë e së cilës ishte shërbimi i burgjeve, shërbimi i provës, njëkohësisht edhe drejtësia e të miturve.

Pjesë e kësaj reforme ishte për të parë nëse ekzekutimi i vendimeve penale të dhëna nga organet gjyqësore zbatoheshin konform rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin që ishte në fuqi. Pa dyshim, në fund të kësaj analize të sistemit të drejtësisë, e cila është bërë publike, u hartua edhe një plan veprimi, ku u sugjerua të bëheshin disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale. Për kujtesë, ka pasur një debat nëse duhej të kishte një ligj të ri të ekzekutimit të vendimeve penale apo thjesht shtesa dhe ndryshime. Misioni i grupit të reformës në atë periudhë ishte që të reflektonte në këtë ligj çfarë ndryshimesh sillte Kodi i Procedurës Penale i amenduar, por në vlerësimin tonë, do të ishte shumë mirë dhe ndoshta Ministria e Drejtësisë të inicioje një paketë të re të ligjeve që lidhen me të drejtat dhe rrëfimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar, sepse edhe ai është ligj i miratuar në prill të vitit 1998, para miratimit të Kushtetutës. E dyta, edhe për ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale. Megjithatë, në këtë projektligj është synuar të zgjidhen disa problematika që janë konstatuar.

E para, mënyra e ekzekutimit vullnetar të dënimeve. Pra, mënyra se si duhet njoftuar një person që ta ekzekutojë vullnetarisht dhe më pas kalohet në ekzekutimin e detyruar.

E dyta, mbikëqyrja nga shërbimi i provës të personave që kanë masë arrest në shtëpi.

E treta, ekzekutimi i vendimeve në rastet kur një i dënuar ndryshon adresën gjatë kohës që është duke vuajtur dënimin.

E fundit, është momenti shumë i paqartë, për të cilin shpesh ka pasur debate midis prokurorisë dhe Shërbimit të Provës, prokurorisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me kohën e vuajtjes së dënimeve kur ekzekutimi është vullnetar. Duhet ekzekutuar vullnetarisht apo kur është dhënë dënimi alternativ? Ky problem është konstatuar më shqetësues në rastet kur gjykatat japin dënime shumë të shkurtra për dënimin alternativ dhe urdhri për fillimin e ekzekutimit të dënimin i dhënë nga prokurori del më vonë sesa data ose periudha midis dhënies së dënimin të formës së prerë dhe nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit nga ana e prokurorit.

Në këtë kuadër të gjitha këto shqetësime të evidentuara në dokumentin analitik të sistemit të drejtësisë janë parashikuar në këtë nismë ligjore.

Qëllimi i kësaj nisme është jo vetëm të përmirësojë procedurat, por mbi të gjitha të respektojë të drejtat e personave të dënuar dhe që kanë kontakte qoftë me organin e prokurorisë, qoftë me sistemin e burgjeve, si edhe me shërbimin e provës.

Nisma ka 8 nene, për hartimin e të cilave janë marrë në konsideratë një sërë shqetësimesh të këtij dokumenti analitik. Kjo nismë i është shtruar konsultimit publik me përfaqësues ose punonjës të praktikës së organeve të drejtësisë penale. Megjithatë, unë në cilësinë e propozueses së kësaj nisme, mbetem e hapur dhe mirëpres çdo sugjerim që mund të bëhet për përmirësimin e saj. E them këtë sepse që nga momenti kur është depozituar nisma ka kaluar një periudhë relativisht e gjatë. Kodi i Procedurës Penale ka filluar të zbatohet në praktikë, sidomos ndryshimet e reja të tij. Mund të kenë dalë probleme në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e ligjit. Do të ishte me interes që problemet që mund të kenë dalë për shkak të paketës së re të reformës së drejtësisë penale mund të reflekttoheshin dhe mund të adresoheshin mirë nëse kanë lidhje me ligjin që ne po diskutojmë.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, në këtë projektligj janë mbajtur parasysh jo vetëm ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, por edhe fakti që në vitin 2017 është miratuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit dhe një pjesë e mirë e dënimeve që lidhen me të miturit janë të rregulluara në këtë kod, megjithatë kërkohet një vëmendje dhe një lidhje midis Kodit të Drejtësisë Penale të të Miturve dhe këtij ligji.

Unë do të doja të theksoja se jam fëmijë e kësaj nisme, por nisma është produkt edhe i një pune të bërë nga ekspertët që u angazhuan në kuadër të reformës në drejtësi. Me këtë rast gjej edhe një herë mundësinë për t'i falënderuar për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë reformë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**- Përfaqësuesit e ministrisë, a keni ndonjë mendim për të shprehur?

**Irir Bejko**- Në parim ministria shprehet dakord, janë disa çështje që ne duhet të trajtojmë duke filluar nga neni 1.

**Ulsi Manja**-Do të kalojmë në votimin në parim, ndërsa nën për nën do ta kalojmë në mbledhje të tjera.

A kanë ndonjë mendim, përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme?

**Artur Selmani**- Në parim jemi dakord.

**Adnor Shameti**- Faleminderit!

Ashtu siç zonja Hysi e paraqiti në fjalën e saj, si propozuese e këtij projektligji, para Komisionit të Ligjeve është sjellë projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale. Arsyeja kryesore e paraqitjes së këtyre ndryshimeve konsiston në mënyrën e njoftimit të të dënuarve gjatë ekzekutimit vullnetar, gjatë fazës së hetimeve ose gjyqimit, të cilët kanë qenë në gjendje të lirë ose me masë sigurimi arrest në shtëpi, mbikëqyrjen nga shërbimi i provës së personave me masë sigurimi arrest në shtëpi, ekzekutimin e tij në periudhën e fillimit të vuajtjes së dënimeve alternative, si dhe problematikën që paraqesin ekzekutimet e vendimeve me masa mjekësore dhe edukuese të dhëna me vendim gjyqësor. Në strategjinë e reformës në drejtësi përkatësisht në shtyllën 3, që ka të bëjë me drejtësinë penale, objektivi 6 parashikon rritjen e efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale, ku përcaktohet se ndryshimet ligjore në sistemin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve në rastet kur i dënuari ndryshon adresën e vendbanimit, do t'i shërbejnë përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues lidhur me ekzekutimin e masave edukuese dhe mjekësore, si dhe krijimin e institucioneve të posaçme për ekzekutimin e këtyre masave, garantimin e ekzekutimit të drejtë dhe të njëjtë të vendimeve gjyqësore në respektimin e lirisë dhe sigurisë së personit, ridimensionimin e rolit të gjykatës dhe të prokurorit në ekzekutimin e vendimeve penale duke synuar rritjen e efektshmërisë së sistemit të ekzekutimit, zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të burgjeve bazuar në harmonizimin e vazhdueshëm me standardet ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e

tyre, si dhe në krijimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionale të pajisur me burimet e nevojshme materiale dhe njerëzore për trajtimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit të institucioneve penitenciare, si dhe atyre të shërbimit të provës.

Për sa më sipër, ftoj të gjithë anëtarët e komisionit që në parim ta miratojmë nismën e paraqitur.

A ka pyetje nga kolegët?

**Bashkim Fino** – E dëgjova me shumë vëmendje zonjën Hysi, më vjen mirë dhe e falënderoj që ka marrë një nismë të tillë, aq më tepër që ky projektligj daton para miratimit të Kushtetutës. Por unë kam një pyetje: pse Ministria e Drejtësisë nuk ka reaguar më parë? Jam shumë i kënaqur që është reaguar, por pse nuk është reaguar më parë? Ky është një ligj i miratuar në prill të vitit 1998, dhe realisht kanë kaluar shumë vite, por ne mund të kishim bërë ndryshime më parë në shërbimin e provës.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është edhe përgjigjja brenda.

A ka pyetje të tjera nga kolegët? A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë e hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord në parim me këtë projektligj?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331/21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar””.

Ka diçka për të shtuar relatori për ecurinë e mëtejshme të projektligjit?

**Adnor Shameti** – Zoti kryetar, në vijim mendoj të përcaktojmë një seancë tjetër, ku të analizojmë me detaje të gjitha gjetjet dhe propozimet për shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

Duke qenë se Komisioni i Sigurisë Kombëtare, si komision për dhënie mendimi, e ka kaluar këtë projektligj në parim, nen për nen dhe në tërësi, u tha këtu nga kolegja Hysi, por edhe nga relatori, zoti Shameti, që ky projektligj ka nevojë që, para miratimit nen për nen, t’i nënshtrohet një diskutimi më të gjerë, për shkak se edhe Kodi i Procedurës Penale ka hyrë në fuqi më 1 gusht

të vitit 2017 dhe ka nisur zbatimin e Kodit të Procedurës Penale. Duke shfrytëzuar edhe rastin që këtu kemi prezentë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, të Prokurorisë së Përgjithshme, të Shërbimit të Provës, por edhe të misionit Euralius, do t'i kërkoja relatorit dhe këshilltarëve që ky draft t'u dërgohet edhe aktorëve të tjerë, përveç përfaqësuesve që kemi këtu, për të marrë opinionet dhe komentet, edhe pse është ndërhyrje e pjesshme në ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe unë bashkohem me mendimin e nismëtares, që do të duhej të kishte ardhur si paketë. Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ligji "Për trajtimin e të dënuarve me burgim", si dhe ligji "Për Shërbimin e Provës" duhet të kishin ardhur në formë pakete, por deri në ardhjen e këtyre projektligjeve nga qeveria, ne duhet t'i japim zgjidhje këtij projektligji, që është një projektligj i depozituar në kuadrin e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi dhe këto ndërhyrje janë të domosdoshme. Pra, duke u bashkuar me sugjerimin e relatorit, për t'u dhënë kohë të gjithë aktorëve të përfshirë në diskutimin e këtij projektligji, do ta shtyjme diskutimin dhe shqyrtimin nën për nen të këtij projektligji për mbledhjen e radhës.

Këtu e mbylлим pikën e parë të rendit të ditës.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar””, nismë e Këshillit të Ministrave.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço.

#### **Të ftuar:**

Bledar Doracaj - Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Viktor Gumi- Ekspert

Vangjel Kosta- Ekspert

Raimonda Bozo – Eksperte

Rudina Brari - Eksperte

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129/11.05.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zoti Bledar Doracaj, drejtor i Përgjithshëm, si dhe ekspertët që kanë punuar me draftin: zoti Viktor Guma, zoti Vangjel Kosta, zonja Rajmonda Bozo dhe zonja Rudina Brari.

Zoti Gumi dhe zoti Kosta mund të afroheni, ju lutem!

Faleminderit për prezencën në komision!

Kush do ta bëjë prezantimin e projektligjit?

**Bledar Doracaj** – Po e bëj unë.

**Ulsi Manja** – Për të bërë prezantimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129/11.05.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar”, fjalën ia kalojmë drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, zotit Bledar Doracaj, më pas relatorit.

**Bledar Doracaj** – Përshëndetje!

Nisur nga problematikat e shumta të hasura pranë sporteleve të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në të gjithë vendin, Ministria e Brendshme ndërmori nismën ligjore për t’i propozuar Këshillit të Ministrave, më pas Kuvendit, disa ndryshime, që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe lehtësimin e shërbimeve në sportelet e gjendjes civile.

Në të gjithë frymën, ndryshimet konsistojnë dhe kanë në fokus përmirësimin dhe lehtësimin e shërbimeve për qytetarët, si dhe përmirësime të tjera, që kanë të bëjnë me funksionalitetin e përditshëm të nëpunësve që ofrojnë shërbime në këto sportele.

Një pikë tjetër e rëndësishme, që ka të bëjë me nismën e ndërmarrë, nisur edhe nga shqetësimi i shumë qytetarëve që paraqiten në sportele, pranë drejtorisë së përgjithshme, por edhe në rrugë apo me postë elektronike, kemi propozuar pezullimin e masës administrative “gjobë”, për një periudhë prej 6 muajsh për ndryshimin e panjoftuar të vendbanimit. Kjo do të thotë që një

numër i konsiderueshëm shtetasish banojnë *de facto* në një adresë të padeklaruar dhe *de juro* banojnë në një adresë ku realisht nuk banojnë.

Ligji sot parashikon që të gjithë shtetasit, të cilët nuk regjistrojnë vendbanimin brenda afateve ligjore, kanë masë administrative (afati ligjor është 30 ditë) “gjobë me 10 mijë lekë të rinj”. Ne propozojmë që kjo masë administrative “gjobë me 10 mijë lekë të rinj” të pezullohet për një periudhë prej 6 muajsh, me qëllim që t’u japim mundësi të gjithë shtetasve ta regjistrojnë vendbanimin aty ku ata banojnë realisht.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Doracaj!

Zonja Xhina...

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për prezantimin e nismës!

Pranë komisionit tonë, i cili është komision përgjegjës për këtë projektligj. Kanë ardhur dy projektligje të cilat synojnë ndryshimin e ligjit “Për Gjendjen Civile”, nr.10129, datë 11.05.2009. Nisma që u prezantua është projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili ka në fokus të tij përmirësimin dhe lehtësimin e shërbimeve pranë sporteleve të Gjendjes Civile, për më tepër rregullon çështje të natyrës administrative, që lidhen kryesisht me administrimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, me rregullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësve pranë Gjendjes Civile. Vlen të theksohet pezullimi i masës së gjobës ndaj qytetarëve, të cilët nuk kanë deklaruar akoma vendbanimin e tyre, pasi deri tani ka rezultuar problematik dhe shumë qytetarë nuk kanë arritur ta bëjnë këtë deklaram. E konsiderojmë shumë të rëndësishëm, pasi do t’u vijë shumë në ndihmë qytetarëve, që brenda këtyre 6 muajve të formatizojnë vendbanimin e tyre për ta regjistruar më pas në Gjendjen Civile.

Për më tepër, ky projektligj synon përmirësimin e shërbimit pranë sporteleve dhe lehtësimin e ndihmës ndaj qytetarëve, si dhe përmirëson procedurën administrative të gjendjeve civile.

Në këto kushte, duke qenë se në parim ia vlen të kalohet, pasi është projektligji i rëndësishëm, sepse, siç thamë, përmirëson pjesë të rëndësishme të ligjit; për më tepër, në dispozita të veçanta do të shihet me kujdes, do të flitet me grupet e interesit, do të priten propozime prej tyre për ta sjellë në mënyrën e duhur në komision; në këto kushte projektligjin e propozuar nga KM-ja mendoj se duhet ta kalojmë në parim në komision për t’u parë më pas në dispozita të veçanta.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Qefalia!

**Xhemal Qefalia** - Faleminderit!

Ky është një ligj, i cili ka një fleksibilitet dhe njëfarë ndjeshmërie, aq më tepër që vitin e ardhshëm jemi në fushatë elektorale. Doja të pyesja drejtorin nëse me sjelljen e këtij drafti bëhen rregullime në Regjistrin Qendror Kombëtar, dhe a e përmirëson kjo listën e zgjedhësve, pasi shpesh subjektet politike në të tilla raste kanë kontestimet e tyre. Po të kemi parasysh se ky ligj mund të hyjë në fuqi, në muajin nëntor, se kështu i bie po të ecë sipas logjikës të miratimit të ligjit, ndoshta edhe në Kodin Zgjedhor është parashikuar që deri 40 ditë para, me sa më kujtohet mua, del lista përfundimtare. Pra, a do të ndikojë në përmirësimin e listës së zgjedhësve?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Urdhëroni, zoti Doracaj!

**Bledar Doracaj** - Faleminderit!

Unë mendoj dhe besoj se çdo nismë ligjore, e cila përmirëson ose kthen në legjitimitet shtetasit, të cilët nuk banojnë aty ku votojnë, në rastin konkret, sjell automatikisht përmirësim të listës së zgjedhësve.

Ajo çfarë unë do të doja të shtoja, se nuk e thashë pak më parë, është se ne si Drejtori e Përgjithshme e Gjendjes Civile, edhe në qoftë se të kemi fluks të shtuar në sportele nga qytetarët që duan të ndryshojnë e vendbanimeve në vendbanimet ku ajo jetojnë realisht, kemi marrë të gjitha masat që të punojmë edhe me orar të zgjatuar për t'i shërbyer edhe qytetarit të fundit.

**Ulsi Manja** - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** - Faleminderit!

Faleminderit drejtorit të përgjithshëm dhe gjithë specialistëve që janë këtu!

Është një nismë shumë e mirë dhe, ashtu siç tha edhe relatorja, ka një draft nga një grup deputetësh për problematikën, por, natyrisht, projektligji i qeverisë është më i kompletuar, më i saktë.

Më vrau veshin fjalia që tha drejtori se do të heqim gjobën prej 10 mijë lekësh për një periudhë 6- mujore.

Pyetja ime është kjo: A është e mjaftueshme që të pezullohet gjoba vetëm 6 muaj?

Këtë periudhë 6-mujore unë e kuptoj se është për 6-mujorin e parë të vitit tjetër, sa të miratohet ligji, të hyjë në fuqi, të dekretohet nga Presidenti, pra të mos duket sikur po u themi qytetarëve se ne po interesohemi për ju jo vetëm para zgjedhjeve, por edhe pas zgjedhjeve për të bërë rregullimet e nevojshme. Pra, mos duhet një kohë pak më e gjatë, 1 vit? Pra, si e ka studiuar dhe si e ka vendosur Ministria e Brendshme këtë afat kohor 6-mujor që e pezullon këtë masë gjobe me të drejtën për të bërë këtë rregullim?

**Ulsi Manja** - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Doraci!

**Bledar Doracaj** – Në mos gaboj, në ndryshimet e fundit ligjore të ligjit nr.10129, që janë bërë parvjet, ne kemi kërkuar përsëri një periudhë 6-mujore amnistie dhe një numër i konsiderueshëm shtetasish regjistruan adresën atje ku ata banonin realisht.

Nisur nga kërkesat e shumta që vijnë, ne kemi vlerësuar një afat 6 muaj. Mendoj se është një afat i mjaftueshëm, kuptohet që gjatë këtij afati duhet edhe një komunikim intensiv me publikun që ata të sensibilizohen se kjo mbase mund të jetë amnistia ose pezullimi i fundit i masës administrative dhe nuk mund të shkojmë njëherë në dy vjet në pezullim masash administrative. Mbase duhet bërë edhe një komunikim intensiv që t'i sensibilizojmë që të paraqiten pranë sporteleve.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Çuçi!

**Bledar Çuçi** - Faleminderit!

Në radhë të parë, dua të them se mbetem i parimit që s'duhet të ketë fare gjobë, në përgjithësi për transferimin, se është përgjegjësi e çdo shtetasi që të deklarojë një adresë ku të ketë marrëdhënie me shtetin, por kjo është bindja ime personale. Tashmë ligji i Gjendjes Civile është konsoliduar në zgjidhjet që ka dhënë me shtrëngime, me gjoba edhe me masa administrative.

Pyetja ime është: A ka një pasqyrë të realitetit se sa e madhe është masa e njerëzve të cilët jetojnë në një vend dhe kanë adresën në një vend tjetër. Pra, sa për qind e popullsisë nuk e kanë bërë akoma deklarimin e vendbanimit të tyre, vendit ku banojnë? Prej këtu, shkojmë te pyetja tjetër: pse gjashtë muaj dhe jo një vit, tre muaj apo nëntë muaj?

E dyta, është edhe ajo që tha drejtori, por do të doja të dija diçka më konkrete: a ka tashmë Drejtoria e Gjendjes Civile apo Ministria e Brendshme, një fond në dispozicion, që do ta vërë në funksion të sensibilizimit të qytetarëve? Sepse kjo nuk bëhet thjesht me një proces normal rutinor

administrativ, por kërkon një proces intensiv të komunikimit me publikun, që ka një kosto shtesë, gjë të cilën Ministria e Brendshme duhet ta ketë pa tjetër. Po nuk e pati, kot sa e bëjmë edhe këtë ndryshim, sepse do të mbetemi po aty ku ishim, megjithëse i japim edhe gjashtë muaj shtetasve, sepse, kur s'ë kanë bërë për kaq vite... Ne kemi pasur edhe amnisti të tjera në lidhje me këtë çështje, por prapë s'kanë dhënë ndonjë efekt.

Kështu, unë mendoj se ne duhet ta miratojmë këtë ndryshim. Për mua, e thashë, le ta heqim fare. Jo gjashtë muaj, por s'duhet të ketë fare penalitet, por nëse e vendosim gjashtë muaj, detyrimisht duhet të kemi këtu edhe planin e komunikimit me shtetasit për këtë çështje. Përndryshe, investohet Kuvendi për iniciativa ligjore, të cilat s'kanë asnjë efekt.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Doracaj!

**Bledar Doracaj** – Faleminderit!

Unë mund të deklaroj me përgjegjësi të plotë, se është ende një numër i konsiderueshëm qytetarësh, të cilët nuk e kanë vendbanimin aty ku banojnë. Nuk di t'jua them me përqindje, por nga të dhënat që ne kemi prej sistemit të adresave, prej adresarit të ri që sapo ka përfunduar, kemi një disbalancë nga të dhënat që ne kemi në Regjistrin Kombëtar të Adresave, të Gjendjes Civile dhe të dhënat që kemi gjetur në terren.

Për këtë arsye, unë mendoj se për gjashtë muaj, ashtu sikurse e thatë, në qoftë se do të kemi një komunikim intensiv, ne do të mund t'ia dalim. Për aq kohë sa Ministria e Brendshme dhe Këshilli i Ministrave kanë sjellë në Kuvend një propozim, besoj se fondet janë aty për të bërë një komunikim sa më intensiv.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit, zoti Doracaj, për nismën e depozituar.

Unë kam dy pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me një shqetësim, që besoj është publik, e njohin të gjithë, në lidhje me shtetasit shqiptarë, të cilët kanë emër e mbiemër tjetër, e që kanë qenë të detyruar të ndryshojnë emrin dhe mbiemrin për shkak të dokumentacionit, sidomos në shtetin grek, ose në ndonjë shtet tjetër.

Ky është një shqetësim i ngritur edhe në vitin 2013, kur kemi diskutuar disa shtesa dhe ndryshime në këtë ligj. E kemi diskutuar edhe në vitin 2016. Patëm një përgjigje, e cila do të shihet në vijim. Ja tek vjen projektligji sot përsëri, për t'u amenduar, por nuk shoh që ky problem të gjejë zgjidhje.

A është menduar të zgjidhet një herë e përgjithmonë problemi i shtetasve shqiptarë, që mund të kenë ndërruar emrin ose mbiemrin, të cilat kanë jetuar ose jetojnë në mënyrë të parregullt në ato vende? E para kjo.

E dyta, në ligj flisni për korigjimin e gabimeve, gabimit material. Është gjë shumë e mirë që e bëni këtë duke ndjekur një procedurë administrative, pa e çuar në gjykatë.

Çështja lidhur me personat që nuk e kanë emrin apo mbiemrin e papërshtatshëm, por kanë probleme, të cilat lidhen me mënyrën se si ata kanë operuar jashtë vendit, si është menduar të zgjidhet?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Zoti Doracaj.

**Bledar Doracaj** – Faleminderit!

Besoj se të dyja pyetjet mund t'i trajtojmë me një përgjigje, sepse kanë të bëjnë me ndryshimin e njërit prej përbërësve të gjendjes civile, që është emri apo mbiemri.

Në 2013-ën Kuvendi i Shqipërisë, me kërkesë të institucioneve të BE-së këtu, kanë miratuar ndryshimet në ligjin “Për gjendjen civile”, ku ndalohej ndryshimi i emrit e i mbiemrit.

E vërtetë se është në rritje numri i kërkesave që vinë nga qytetarët për të ndryshuar emrin, mbiemrin ose për ta kthyer në origjinë, në qoftë se e kanë ndryshuar më parë, po për këtë kemi një pengesë ligjore.

Së bashku me stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile kemi filluar të mendojmë që së shpejti do të kryejmë edhe ciklin e konsultimeve me institucionet ndërkombëtare, që atëherë, për shkak të procesit të integritit europian, kanë kërkuar ndalimin e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit. Mbase ka ardhur koha që ne ta rihapim këtë tezë diskutimesh. Në çastin kur të dakordësohemi me ta, por edhe brenda nesh, për të bërë ndërhyrjen e fundit, që të jetë edhe sa më e sigurtë për ta lidhur me institucionet e tjera ligjzbatuese, do të vijmë në Kuvend me këtë iniciativë për ta ndryshuar. Sot kemi një vlerësim të situatës, por nuk kemi ende një iniciativë për ta lejuar këtë proces.

**Ulsi Manja** – Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka diskutime? Nuk ka.

Meqenëse kemi dy nisma për ndryshim të ligjit 10129, unë mendoj të kalojmë edhe në prezantimin e nismës tjetër në ligjin “Për gjendjen civile”. Pastaj t'i votojmë në parim. Më pas në fazën e diskutimit nen për nen, besoj se do të jetë mundësia t'i bashkojmë të dy nismat.

Nisma e dytë është nismë e deputetëve. Është një grup deputetësh, të cilët kanë propozuar përsëri ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile”. Është një grup prej rreth njëzet deputetësh. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen ekspertët që kanë punuar në fakt me këtë projektligj zoti Viktor Gumi, zoti Vangjel Kosta, zonja Rajmonda Bozo dhe zonja Rudina Brari. Në emër të deputetëve propozues, kush do ta prezantojë nismën?

Po, kolegja, zonja Vasilika Hysi

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kjo është një nismë e 19 deputetëve. Unë do të bëj një prezantim të përgjithshëm, duke u lënë më pas fjalën ekspertëve të prezantojnë nismën në aspektin teknik.

Disa vite më parë Kuvendi i Shqipërisë dhe në vijim ka marrë në mënyrë sistematike raporte të organizatave të shoqërisë civile vendase dhe ndërkombëtare, ku ka ngritur një shqetësim dhe i ka kërkuar Kuvendit të adresojë shqetësimin e mbrojtjes së të drejtave e fëmijëve në përgjithësi dhe regjistrimin e lindjeve të fëmijëve në veçanti. Ka pasur dhe ka probleme me dy kategori lindjesh, me fëmijë që lindin jashtë vendin, ku prindërit jetojnë në mënyrë të parregullt ose kanë jetuar në mënyrë të tillë, më pas janë depërtuar dhe nuk kanë mundësi të sigurojnë dokumentacionin e lindjes.

Kategoria e dytë janë fëmijë që lindin brenda vendit, që për rrethana të prindërve të tyre nuk i kanë regjistruar fëmijët. Ky është një problem kryesisht në komunitetin rom.

Në të gjitha raportet ndërkombëtare ku flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe për pakicat është theksuar detyrimi i shtetit shqiptar për të zgjidhur njëherë e përgjithmonë këtë problem. Regjistrimi i fëmijëve ka të bëjë edhe me parandalimin e tyre për të qenë viktima të abuzimit, të skllavërisë moderne, të të gjitha formave, duke përfshirë këtu: trafikimin, lypjen, shfrytëzimin për punë, për shitjen e organeve e kështu me radhë, për 20 vjet nuk gjeti zgjidhje.

Së fundi grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi thirri një mbledhje ku bëri një konsultim të gjerë publik. Patëm një kërkesë nga përfaqësuesit, ekspertët e TILAS-it dhe të UNHCR-së për t’u dëgjuar. Në këtë dëgjese publike u prezantuan gjetjet e raportit, por edhe të raporteve të organizatave të tjera si: UNICEF, *Save the Children* dhe u konstatua se problemi ishte ligjor dhe një neglizhencë për gati 20 vjet. Në këtë kuadër pas diskutimeve të bëra në grupin e deputetëve, Miqtë e Fëmijëve, në fund të mbledhjes, Kryetari i Kuvendit, që drejton edhe grupin kërkoi që brenda një periudhe të shkurtër, brenda fundit të



muajit shtator deputetët të depozitojnë një nismë dhe t'i jepnin zgjidhje njëherë e përgjithmonë këtij problemi, duke kërkuar asistencën e TILAS-it, një organizatë e mirënjohur, me shumë përvojë, e cila për më se 20 vjet ka asistuar falas regjistrimin e fëmijëve të shtetasve shqiptarë të lindur jashtë vendit ose brenda tij.

Në këtë kuadër u bë një takim i dytë i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” dhe TALAS-i së bashku me ekspertët e vet, që janë ekspertë me shumë përvojë prezantuan propozimet dhe amendamentet përkatëse.

Amendamentet që ju, të nderuar kolegë keni përpara janë firmosur nga 19 deputetë, një pjesë janë deputetë që i përkasin grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, të tjerë jo. Mund të kishte edhe më shumë firma, sepse gjeti një mbështetje shumë të madhe nga të gjithë deputetët, sapo e mësuan nismën, por ky ishte thjesht një formalitet, firmosja nga 19 persona.

Morëm këtë nismë, e cila bazohet në të gjithë punën, angazhimin, përkushtimin, përvojën e ekspertëve dhe të TILAS-it.

Unë do të doja t'ju falënderoja shumë, në mënyrë të veçantë TILAS-in dhe stafin, por edhe të gjithë ekspertët që janë angazhuar, jo vetëm në hartimin e kësaj nisme, por edhe në adresimin, në zgjidhjen e shumë problemeve që kanë hasur fëmijët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit dhe njëkohësisht të gjithë donatorëve që kanë mbështetur shpenzimet e larta të regjistrimit dhe të përgatitjes së regjistrimit të fëmijëve apo edhe të proceseve gjyqësore, duke përfshirë edhe analizën e ADN-së!

I nderuar zoti kryetar, të dy ekspertët kolegu i nderuar Viktor Gumi dhe gjyqtari, profesori i Shkollës së Magjistraturës zoti Vangjel Kosta bënë një prezantim të projektligjit në grup. Prandaj po jua kaloj fjalën atyre për ta prezantuar atë edhe para komisionit.

Ju falënderoj edhe një herë për adresimin e një problemi që për 20 vjet nuk mundi të zgjidhej!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Gumi.

**Viktor Gumi** – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Teksti i projektligjit që paraqitet për diskutim dhe për shqyrtim në Komisionin e Ligjeve me iniciativën e deputetëve është një tekst, i cili ka buruar siç u theksuar më parë nga disa studime

që kanë bërë organizatat jofitimprurëse së bashku me disa organizata ndërkombëtare “Për eliminimin e riskut të pashtetësisë”. Në atë studim u identifikuan disa probleme, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kategorinë më vulnerabël të shoqërisë dhe me pamundësinë për t’u regjistruar në gjykatë. Grupi ndërparlamentar “Miqte e fëmijëve” kërkoi bërjen e amendamente konkrete në ligjin “Për gjendjen civile”, me qëllim që në ligjin i ri këto të adresoheshin dhe të gjenin zgjidhje përfundimtare.

Fokusi i parë i ndërhyrjes kryesore që është parashikuar në ligj është që të rregullojë në mënyrë ligjore atë që sot refuzohet të kryhej nga gjykata. Konkretisht, gjykatat shqiptare refuzonin të merrnin në shqyrtim dhe të bënin rregullimin e situatës juridike të akteve të lindjes, të cilat ishin lëshuar nga organe të tjera të vendeve ku ka emigracion të lartë në Greqi, Itali apo edhe në vende të tjera të BE-së. Shpeshherë këto dokumente kanë të dhëna të paplota, sidomos në rastet e Greqisë, kanë të dhëna të pasakta, të cilat kërkoheshin që të reflektoheshin në gjendjen civile. Kauzat, çështjet që ka ndjekur TILAS-i kanë arritur deri në afate 19 - vjeçare, ku një individ që është kthyer nga Greqia ka 19 vjet që nuk mund të regjistrohet në regjistrin e Gjendjes Civile. Ne e kemi konsideruar si të drejtë bazë këtë gjë. Shpeshherë në teori dhe në jurisprudencë konsiderohet regjistrimi në gjendjen civile si e drejta për të pasur të drejta, sepse prej kësaj të drejte burojnë në sërë të drejtash të tjera, siç është e drejta e edukimit, e drejta e mbrojtjes sociale, e drejta e shkollimit e kështu me radhë. Për pasojë, vlerësuam që në ligjin për gjendjen civile duhet t’i çelim juridiksionin dhe kompetencën gjykatës shqiptare nëpërmjet një instrumenti klasik që ajo e ka në Kodin e Procedurës Civile, e cila ka të bëjë me vërtetimin e faktit juridik. Pra, edhe për akte të cilat prodhohen nga organe të tjera, kur është e domosdoshme dhe kërkohet kriteri që ka rubrika të pasakta dhe të paplota, gjykata shqiptare, me kërkesë të të interesuarit, të bëjë të mundur vërtetimin e faktit juridik për këtë çështje.

Në diskutimet tona kemi pasur një dilemë nëse kjo dispozitë do të jetë në ligjin për gjendjen civile apo në një ligj klasik, siç është Kodi i Procedurës Civile dhe ne gjykuam dhe vlerësuam se kjo e ka vendin këtu dhe mund të rregullohet këtu.

Së pari, edhe vetë praktika e parlamentit ka qenë e një natyre të tillë, që instrumentet që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, siç është rasti për disa masa ndaj dhunës në familje, nuk parashikohen në ligjet organike me 3/5-at, por në ligje me shumicë të thjeshtë, ndryshe nga ligji material, ku tashmë ka një qëndrim të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, që veprat penale

dhe kundërvajtjet penale parashikohen vetëm në Kodin Penal dhe jo në ligje me shumicë të thjeshtë.

Së dyti, ne nuk po ndryshojmë konceptin e vërtetimit të faktit juridik, por po e huazojmë atë, po e vendosim në ligj, por duke vendosur subjektet e kërkesës dhe afatet të posaçme procedurale për gjykim, posaçërisht në shkallë të parë, në afatin e ankimit dhe pastaj në gjykimin në dhomë këshillimi.

Së treti, dispozitat e paraqitura në tekstin e këtij projektligji reflektojnë një parim të rëndësishëm, atë që, së pari, është detyrimi i prindërve që të veprojnë për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile, të cilët kanë një afat kohor të caktuar në dispozicion dhe, në rast se ka mosveprim, neglizhencë apo elemente të tjera, që bëjnë të pamundur regjistrimin e këtyre fëmijëve, atëherë shteti nuk mund të rrijë indiferent ndaj kësaj gjendjeje, por duhet të ndërhyjë për të mundësuar regjistrimin e këtyre fëmijëve. Pse duhet kjo? Sepse është rasti klasik, është e drejta për të pasur të drejta dhe shteti nuk mund të rrijë indiferent si një *domain* që u përket vetëm prindërve. Prindërit janë ata të parët që duhet të bëjnë regjistrimin, por me një afat kohor të caktuar dhe, nëse ata tregojnë neglizhencë, mosveprim apo elemente të tjera që nuk e mundësojnë regjistrimin, atëherë është detyrë e shtetit të plotësojë këta regjistra me këta individë që jetojnë në territorin e tyre dhe për këtë kemi bërë të mundur krijimin e regjistrit të posaçëm. Ne gjykojmë se ky regjistër është një mekanizëm i cili do të ketë efekt kur institucionet e caktuara shëndetësore, ku bëhet lindja, bëjnë regjistrimin në regjistër të posaçëm dhe aty fiksohet e regjistrohet kjo lindje. Brenda një afati kohor 60 ditor prindërit duhet të shkojnë të bëjnë regjistrimin e aktit të lindjes dhe me kalimin e këtij afati kohor, secili prej këtyre regjistrave të përkohshëm do të nxjerrë një flamur të kuq që ka kaluar afati. Këta individë që shfaqen me këtë kalim afati do të hyjnë në skemë për të bërë regjistrimin e aktit të lindjes në regjistrat e gjendjes civile. Në vijim të këtyre procedurave ka disa dispozita të caktuara, të cilat prekin nene të veçanta, që, për hir të ndryshimeve në një nen, është i detyruar të preket edhe një nen tjetër.

Gjithashtu, në zbatim të asaj që u vendos në mbledhjen e grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve”, ku iu la detyrë ekspertëve të rishikojnë kuadrin ligjor të çregjistrimit nga regjistrat e gjendjes civile të personave që kanë vdekur dhe që për një ose dy arsye të tjera, pavarësisht se kanë vdekur në një kohë të caktuar, nuk shfaqen të çregjistruar, së bashku me ekspertët e ministrisë kemi bërë një skanim të të gjithë mekanizmit dhe kemi identifikuar tri dispozita, që gjykojmë dhe vlerësojmë se kanë nevojë për ndërhyrjen e ligjvënësit, duke përcaktuar disa parime të

përgjithshme si tek akti i lindjes, ashtu edhe te parimi, që fillimisht vepron individi pastaj, nëse nuk vepron, do të futen institucionet shtetërore për të vepruar. Të njëjtën gjë kemi bërë edhe në rastin e regjistrimit të vdekjeve.

Ligji, gjithashtu, ka detaje teknike, kërkon nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse është e nevojshme dhe e domosdoshme. Për hir të natyrës teknike të procesit, ato janë të pamundura të parashikohen në këtë pjesë të tekstit të projektligjit dhe në këtë aspekt ne kemi bërë të mundur caktimin e dispozitave, të cilat për nga karakteri normativ e kanë vendin në ligj, por që njëkohësisht i kemi siguruar lirshmëri të gjitha organeve që të kenë fleksibilitetin e nevojshëm për ta zbatuar sa më mirë në praktikë tekstin e këtij projektligji.

Të gjitha këto tekste projektligjesh, ashtu siç u prezantua edhe te grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve” janë diskutuar dhe dakordësuar me ekspertët e qeverisë, të cilat besoj se janë plotësisht të mundshme në një afat të shkurtër kohor.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gumi!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky ligj që po vjen për ndryshime, është shumë i rëndësishëm. Këto ndryshime vijnë si rezultat i problematikave të tilla të pafundme që ne si deputetë kemi konstatuar në zonat tona. Kjo do të na bëjë më të kujdesshëm që, së pari, t’i shohim dhe t’i zgjidhim të gjitha problematikat e mundshme, së dyti, të mos bëjmë kapërcime procedurale, të cilat, në vend që t’i zgjidhin situatat, mund ta vënë organin e gjendjes civile, por njerëzit e thjeshtë në një situatë edhe më të komplikuar. Meqë këtu kam edhe ekspertët, do të doja të bëja nja dy pyetje teknike.

Së pari, profesor, unë kam dyshime të forta nëse mundet që ju me këtë ligj thjesht t’i përcaktoni rregullat procedurale gjykatës. Nuk e di ku jeni bazuar. Ju e dini që gjykatat të gjendura në një fluks të madh nuk po zbatojnë afatet procedurale të Kodit të Procedurës Penale apo Civile. Nuk e di nëse do të zgjidhet kjo çështje me vendosjen e disa afateve dhe nëse do t’i zbatojë gjykata që e ka detyrim. Ndonjëherë duket sikur vëmë disa afate dhe duket se po bëjmë nder, por nuk bëjmë asnjë punë. Unë mendoj se mund të jepeshin zgjidhje me akt administrativ.

Së dyti, a keni bërë ndonjë analizë se cilat janë të dhënat kryesore, ndoshta ju e cituat pak, që mungojnë në akte në ndryshime, sepse për mua në shumë raste nuk është se mungon në aktin zyrtar të shtetit, por janë individët, të cilët ose nga mosnjohja e ligjit ose nga mosveprimi i tyre,

nuk kanë arritur t'i marrin të dhënat. Shoh që në raste specifike ju u jepni zgjidhje, për shembull për plotësimin e ndonjë të dhëne, siç është neni 6, me të cilin kërkoni të ndryshoni nenin 45, pra u jepni mundësi për të korrigjuar emrin, ose për ta plotësuar emrin kur mungon. Thoni: “me akt nënligjor të ministrit përkatës”. Për mua duhet ngritur niveli i aktit nënligjor. Po flasim për të dhëna në regjistrin themeltar të shtetit. Unë mendoj se, pa paragjykuar asnjë ministër, përcaktimi i rregullave përkatës duhet të jetë në nivelin e Këshillit të Ministrave, pra të mos jetë me udhëzim, por me VKM.

Ju lutem, më jepni këto dy shpjegime për të kuptuar nëse po bëjmë gjë apo jo me to.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka zoti Kosta.

**Vangjel Kosta** – Faleminderit!

Shqetësimi është i drejtë. Pavarësisht se ne sot vijmë me një draft final, ju siguroj se kemi pasur diskutime shumë të gjera dhe në tryeza të shpeshta lidhur me këtë çështje. Situata shtrohet pak më thjesht. Në pikëpamjen formale ligjore çdo shtetas duhet të shkojë në vendin ku është mbajtur akti dhe të ballafaqohet me organin që ka lëshuar aktin për të bërë korrigjimet përkatëse. Ky është standardi ndërkombëtar.

Çfarë na rezulton neve nisur nga përvoja e TLAS-it dhe organizatave të tjera?! Shumë nga shtetasit, të cilët janë në vështirësi ekonomike, e kanë të pamundur të ndjekin këtë rrugë. Pyetja është: shteti shqiptar do t'i lërë këta shtetas të vuajnë pasojat e mosveprimeve që ata kishin kryer në momentin kur u mbajt akti, pra nuk u treguan aktivë apo të saktë për të marrë një akt të përshtatshëm, apo duhet të gjejmë mekanizma të cilët t'u vijnë në ndihmë këtyre?

Viktori tha se mekanizmi i përzgjedhur prej nesh është një mekanizëm që ne besojmë se përshtat logjikën e përgjithshme që akti duhet të korrigjohet në vendin ku është mbajtur akti me atë që ne u krijojmë juridiksion gjykatave shqiptare që për këto akte të bëjmë korrigjime për t'u përdorur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të Republikës së Shqipërisë. Pyetja nëse ky është një institut i ri i ngritur në këtë ligj apo është thjesht delegim nga ligji procedural te ligji i posaçëm, unë besoj se e ka përgjigjen, siç u tha edhe më lart. Instituti i Vërtetimit të Faktit ka vite që është pjesë përbërëse e praktikave të gjykatave shqiptare, sipas Kodit të Procedurës Civile. Në thjesht kemi çuar në vëmendje të gjyqtarëve që këtë vërtetim fakti mund ta bëjmë edhe për rastet kur fakti ka ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Besoj se nuk po bëjmë shpikje, thjesht po zgjerojmë ose po interpretojmë, përsëri me ligj, për gjykatat zgjerimin e juridiksionit.

Ndërsa shqetësimi i dytë, që u ngrit në tryezën e organizuar më parë, nëse këto vendime do të jenë të mundshme, apo jo të ekzekutohen, besoj se e ka zgjidhjen te Kodi i Procedurës Civile, i cili thotë: “Faktet që provon gjykata në prani (dhe jo pa qëllim është kërkuar të thirret zyra e gjendjes civile që do të regjistrojë aktin më pas) të subjektit të interesuar të thirrur në gjykim, janë të pakontestueshme dhe jemi para detyrueshmërisë ligjore të zyrës së gjendjes civile për të bërë këtë regjistrim”. Nuk e di nëse përgjigja ishte e plotë?

**Alket Hyseni** – Profesor, së pari, pyetja ime ishte: a mundeni ne me një ligj të zakonshëm t’i imponohemi proceduralisht gjykatës me afate?

Së dyti, cilat janë të dhënat, a nuk duhet t’i specifikojmë, sepse do të gjendemi në fazën e vërtetimit të faktit të pronësisë? A ju kujtohet se çfarë është bërë me vërtetimin e faktit të pronësisë në Shqipëri? Është bërë katrahura më e madhe, që nuk e zgjidhim dot as sot dhe nuk e dimë se si do e zgjidhim në vijim. Do të bëjmë të njëjtën gjë me gjendjen civile? Është një katrahurë me vërtetimin.

Gjithashtu, nuk jam dakord me përgjigjen e fundit, që ju thoni: “Kodi i Procedurës Civile të jep mundësinë të jetë palë e subjekt të interesuar”. Në këtë rast zyra e gjendjes civile është fiktive si palë, sepse nuk po korrigjon aktet e saja, por po korrigjon aktet e lëshuara nga vendet e tjera. Çfarë roli ka? Ka një rol që të vendimi të bëhet i detyrueshëm. Unë e kuptoj, por nuk është ky rasti që përmend Kodi i Procedurës Civile. Kodi i Procedurës Civile e ka për ato raste kur vërtetimi i faktit është fakti i ndodhur tek ai subjekt i interesuar. Pra, fakt i ndodhur tek institucioni X dhe ai institucion duhet të jetë palë në gjykim. Ndërkohë, në rastin konkret fakti nuk lidhet me institucionin, megjithatë ne do të kemi rast ta diskutojmë më gjatë.

**Vangjel Kosta** - Nuk po i rikthehem pjesës së parë, sepse i bie që të përsëris veten, pra nuk dua t’i rikthehem të njëjtit diskutim.

Lidhur me afatet, duhet të kemi parasysh se këto janë afate më shumë treguese, nxitëse dhe jo me ndonjë pasojë. Shpresoj që vonë, me ngritjen e KLGJ-së, e cila ka instrumentet e duhura që t’i detyrojë gjyqtarët të respektojnë afatet nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit të punës profesionale të tyre, këto afate, nga afate deklarative, të kthehen në afate realiste dhe të realizueshme për qëllimin për të cilin janë vënë. Edhe një herë po e them, ne nisemi nga shqetësimi real, ka pafundësisht persona që kanë dokumente të tillë, në të cilët identiteti i nënës është jo i saktë, jo i plotë dhe, natyrisht, gjykata nëpërmjet këtij instrumenti ka mundësinë që të verifikojë saktësinë nëse nëna që ka lindur këtë fëmijë, dhe jo pa qëllim u përmend ADN-ja si prova e fundit,

por që është e kushtueshme, e cila do të mbyllte shqetësimin, e shprehur me të drejtë nga deputeti, lidhur me frikën se gjykatat mund të abuzojnë me këtë proces. Nga përvojat e deritanishme, nëse gjykatat këto procese nuk i mbyllin pa analizën e ADN-së, frika nga abuzimi mua më duket jorealiste.

**Ulsi Manja** – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Urdhëroni, zonja Xhina!

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç e theksova, është shumë e rëndësishme ardhja e këtij projektligji, pasi synon të rregullojë problematikat e hasura me regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit dhe brenda vendit. Ka shumë probleme të teknikës legjislative, por edhe të përmbajtjes ligjore të dispozitave.

Lidhur me afatet, përsëri nuk jam e bindur që qëndron shpjegimi, pasi nuk mund t'i imponohemi gjykatës për afate të përcaktuara në një ligj specifik, kur ajo ka afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Lidhur me konceptin e vërtetimit të faktit juridik, ky koncept është përcaktuar qartë nga jurisprudenca se kur kemi të bëjmë me një vërtetim fakti juridik dhe u relatua se nga parashtrimi i qytetarit në rastet e pasaktësive mund t'i drejtohet gjykatës për vërtetim fakti juridik, që për mendimin tim del jashtë konceptit të faktit juridik në rastet e pasaktësive. Atëherë, si mund ta bëjmë këtë ndryshim të konceptit të faktit në këtë projektligj? Mund të themi Kodi i Procedurës Civile përcakton mjaft qartë çfarë duhet të bëjmë kur kemi pasaktësi të dokumentit dhe çfarë duhet të bëjmë kur kemi mungesë të dhënash të dokumentit.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Gumi.

**Viktor Gumi** – Në të gjithë grupin e mekanizmave, edhe në diskutimet që u vendosën më përpara, por besoj edhe këtu, së pari, identifikohet si problem dhe duke u identifikuar si i tillë, ne, gjithashtu, duhet të flasim edhe për mekanizmin e zgjidhjes.

Lidhur me mekanizmin e zgjidhjes, nga të gjithë mekanizmat që ne pamë dhe shqyrtuam, gjykuam dhe vlerësuam, edhe nga praktika gjyqësore e TLAS-it, që rasti më garantist që do të mund ta rregullojë këtë problem është vërtetimi i faktit juridik me Kodin e Procedurës Civile, nuk mundemi të gjejmë, për shkak të rolit të gjykatës, investimit, sistemit larg ndikimit të ekzekutivit, një instrument tjetër më të vlefshëm sesa të bëjë të mundur këtë rregullim të situatës ligjore.

Në lidhje me vërtetimin e faktit juridik, ajo që parashikojmë në tekstin e projektligjit nuk është gjë tjetër veçse një huazim i parimit që është vendosur në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, i cili në paragrafin e fundit thotë: “Në mënyrën e treguar më sipër...”, që tregohen dy paragrafët e parë “mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni”. Pra, në qoftë se nuk ke dokument ose ky dokument ka humbur, personi ka të drejtë të kërkojë vërtetimin e faktit juridik. Këtë gjë e bën “edhe për korrigjimin” thotë, jo vetëm kur dokumenti...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është teksti i dispozitës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Viktor Gumi** – Jo vetëm kur akti mungon, jo vetëm kur akti është zhdukur, por paragrafi i tretë i 388-ës thotë: “edhe për korrigjimin futet fakti juridik”, dhe kjo është praktikë gjyqësore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A e përmend 388-a fjalën “në korrigjim”?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Adnor, kur e merr fjalën për procedurë, në fakt, je i saktë!

Fjala është për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke mos dashur t’ua heq të gjithë zellin bashkëbiseduesve në komision, do t’i ftoja që ta ndërpresim diskutimin dhe sqarimet e mëtutjeshme, thonë në Kosovë, për t’ia lënë analizës nen për nen të ligjit, sepse sot kemi vetëm diskutimin dhe miratimin në parim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu që, le të jemi më operativë në këtë pikë.

Faleminderit, zoti Manja!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Nëse ka pyetje të tjera, kush e do fjalën? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në fazën e diskutimit.

Për diskutim e ka kërkuar fjalën zonja Bushka. Do t'ju lutesha të flisni në mënyrë të përmbledhur.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni...

**Klotilda Bushka** – Edhe nisma e paraqitur...

**Ulsi Manja** – ... u mor parasys, sepse kaluam në diskutim!

**Klotilda Bushka** – ...nga qeveria, edhe nisma e paraqitur nga deputetët, janë të dyja të nevojshme, pasi i japin zgjidhje një situatë tashmë të krijuar dhe që i ka ardhur koha të mos jetë më problem. Nuk duhet të ketë asnjë fëmijë të lindur në Shqipëri ose jashtë të paregjistruar dhe me probleme procedurale, qoftë këto administrative apo nëpër gjykata, të cilat e pengojnë këtë regjistrim. Kjo është një e drejtë nga e cila rrjedhin të gjitha drejtat e tjera për individin. Kështu që unë i përgëzoj të dyja nismat.

Për sa i takon modelit të zgjedhur të nisma e paraqitur nga deputetët, që, gjithsesi, e drejta e regjistrimit fillon nga individi me vetëdeklarim dhe nëse ai nuk e bën këtë gjë do të hyjnë pastaj organet e shtetit me mekanizmat e tyre, për mua është zgjidhja optimale, madje më vjen mirë, sepse i shkon për shtat edhe frymës dhe politikës së re të kësaj maxhorance, që qytetari nuk duhet të vuajë më të prodhojë dokumente kur ato janë në zyrat e shtetit, por këto të fundit duhet të koordinojnë me njëra-tjetrën për t'i lehtësuar proceduralisht këto veprime.

Për sa i takon mjetit të zgjedhur procedural, flas këtu për nismën e paraqitur nga deputetët, jam dakord në një pikë me zotin Hyseni dhe me zonjën Xhina. Unë e kuptoj se mjete procedural i zgjedhur, sipas Kodit të Procedurës Civile, vërtetimi i faktit juridik nuk është se bie ndesh me qëllimin që ne duam të arrijmë, por ka një gjë, që i gjithë shqetësimi ynë, si deputetë, është se nesër, me një vendim gjyqësor për vërtetim fakti juridik, do të jetë përsëri e vështirë nga organet e shtetit të bëjnë ekzekutimin e regjistrimit, pra ekzekutimin e detyrimit, sepse vendimi për vërtetimin e faktit juridik është deklarativ, nuk është një vendim i cili detyron palët.

Në këtë koncept do të duhet që ne ta rimendojmë pak se si mund ta bëjmë më efektiv këtë mekanizëm në ligj, në mënyrë që të kemi proces me palë, ku organet shtetërore, dhe kryesisht zyrat e gjendjes civile, do të jenë palë me legjitimitet pasiv, në mënyrë që vendimi të jetë detyrues për

to dhe të ekzekutohet, si dhe të drejtat e njerëzve që fitohen me vendim gjyqësor të jenë më tej të ekzekutueshme.

Për këtë unë do të sugjeroja që gjithë këtë punë të lavdërueshme që kanë bërë ekspertët ta shtrojmë në një tryezë teknike, para se të shkojmë te diskutimi nen për nen, së bashku me deputetët që janë relatorë dhe propozues, edhe me ekspertët dhe me këdo tjetër që është i interesuar në këtë komision apo në Kuvend, në mënyrë që, nga njëra anë, të kemi shqetësimet e qytetarëve pse kemi arritur këtu dhe pse qeveria e deputetët morën këtë nismë, pse jo, nga ana tjetër, të kemi edhe një lloj ekspertize dhe një mendje të njëjtë të gjithë që të gjejmë një mekanizëm: sikur të bëjmë një eksperiment, që nëse ndodh një rast, cili do të jetë mjeti më efektiv që të drejtat, të cilat deri më sot nuk janë realizuar dot plotësisht, kur të vijë momenti i regjistrimit nga organet e shtetit, të jenë të plota.

Kështu, unë do të sugjeroja, zoti kryetar, që para se të kalojmë në shqyrtimin nen për nen, të organizojmë këto takime teknike të konsultimit.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Urdhëroni zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Për këtë që tha kolegja, me ç’tha zonja Hysi, Grupi i Deputetëve Miqtë e Fëmijëve janë mbledhur disa herë nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit dhe mbi bazën e kësaj, ata kanë ngritur edhe grupin e ekspertëve. Pra, përveç qeverisë edhe ekspertët kanë ardhur në to dhe pasi ata kanë votuar, kanë sjellë këtë draft.

Tani çfarë po kërkon Klodi? Të vazhdojmë me ekspertë të tjerë apo t’u lëmë më shumë kohë ekspertëve? Këta kanë sjellë një material. Nëse jemi të pakënaqur nga këta ekspertë dhe mund të japin ndonjë mendim tjetër ekspertët e tjerë dakord, por ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si?

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Mbaruat zoti Fino?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Nuk thashë këtë, por e kam vërtet parimore. Nëse duhet të bëjmë një konsultë tjetër, dakord.

## **Ulsi Manja – Faleminderit!**

Një sqarim në lidhje me këtë që po diskutohet. Eksperti, zoti Gumi, tha se është identifikuar problemi. Pra, në takimet që ka pasur Grupi i Deputetëve Miqtë e Fëmijëve dhe me të drejtë zoti Fino tha se meqë është ardhur në variantin e këtij projektligji që po diskutohet sot në komision, janë bërë tryeza pas tryezash dhe diskutime pa fund, në lidhje me këtë projektligj. E rëndësishme është që është identifikuar një problem, të cilit duhet t'i japim zgjidhje.

Një alternativë është zgjidhja që propozohet në tekstin e këtij projektligji, por edhe në takimin e fundit që u mbajt për këtë çështje, pati diskutime se si qëndron ky projektligj në raport me detyrat dhe funksionet që ka gjykata. Në mos gaboj, ky nen, pra neni 38, që kërkohet të ndryshohet, ka qenë neni më i debatuar.

Duhet të kemi në konsideratë faktin që bëhet fjalë për aktet e lindjes të mbajtura në një shtet tjetër. Pra, jemi në një kushtet, ku kërkohet të zgjidhet një situatë e cila nuk ndodh në shtetin shqiptar, pra ndodh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ne duhet t'i japim një zgjidhje këtij problemi. Çfarë do të bëhet me fëmijët që lindin nga prindër shqiptarë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur aktet e lindjes janë të paplota ose të pasakta, ose në disa raste, nuk janë mbajtur fare?

Gjithsesi, unë jam dakord me mendimet e kolegëve që ne në fazën e diskutimit nen për nen, t'i japim një zgjidhje kësaj çështjeje dhe të mos e vështirësojmë më shumë problemin, sepse rruga e vërtetimit të faktit juridik në gjykatë, shpeshherë e vështirëson problemin.

Zoti Hyseni hodhi idenë e mundësisë së realizimit të kësaj nëpërmjet një akti administrativ, pa shkuar në procedurat e vërtetimit të faktit juridik.

Gjithsesi, unë mendoj se siç u tha nga kolegët me radhë këtu, në fazën e diskutimit nen për nen, para se të vijmë në diskutimin e këtij neni, të organizojmë në Komisionin e Ligjeve një konsultim me deputetët që dëshirojnë të përfshihen në këtë diskutim, me relatorët, me këshilltarët, me ekspertët dhe me përfaqësuesit e qeverisë, që të mos humbasim kohë tek ky nen në fazën e diskutimit nen për nen. Ky është neni që kërkon zgjidhje, sepse nenet e tjera janë të punuara mirë dhe nuk besoj se krijojnë probleme, sepse i janë nënshtruar një diskutimi shumë të gjerë.

Kështu unë them të kalojmë në votimin në parim të të dyja nismave. Nga këshilltarët më thuhet se ato duhet të votohen të ndara edhe në parim, edhe nen për nen dhe në fazën e përpilimit të raportit për në seancë, do të ketë një tekst të integruar.

Kështu, hedhim në votim në parim nismën e qeverisë!

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar””, nismë e Këshillit të Ministrave? Pro?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin në parim të nismës së deputetëve për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar””.

Kush është dakord në parim?

Urdhëroni, zoti Braho!

**Spartak Braho** – Nuk e kemi mirë, se ne po votojmë dy tekste dhe ndoshta, kur t’i votojmë nenet një e nga një, mund të përplasen.

Pse të mos e votojmë tekstin integral që do të paraqitet edhe në parim, edhe nen për nen?

**Ulsi Manja** – Zoti Braho,

Edhe unë kisha të njëjtin shqetësim, meqenëse janë dy nisma, njëra nga Këshilli i Ministrave dhe tjetra është nismë e deputetëve për të njëjtin ligj, por nga shërbimet e Kuvendit më thuhet se në seancë plenare do të ketë një tekst të integruar për votim, por në Komisionin e Ligjeve do të duhet të kalojnë secili nga tekstet në parim, nen për nen dhe më pas, në fazën e miratimit të raportit për në seancë do të kemi një tekst të integruar për secilin nga nenet që ndërhyjnë në ligjin “Për gjendjen civile”.

**Spartak Braho** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Atëherë, kush është dakord në parim me nismën e deputetëve? Pro?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim edhe ky projektligj.

Me këtë votim e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

